



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE

УСТАВНИ СУД

CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 12 dhjetor 2019

Nr. ref.: RK 1481/19

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI82/18

Parashtrues

Limak Kosovo International Airport J. S. C. “Adem Jashari”

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 2/2018, të 9 janarit 2018

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga shoqëria aksionare Limak Kosovo International Airport “Adem Jashari”(në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), me seli në fshatin Vrellë, Komuna e Lipjanit, të përfaqësuar me autorizim nga Fazli Gjonbalaj dhe Leonora Fejzullahu.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 2/2018 (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme), të 9 janarit 2018.
3. Parashtruesi i kërkesës vendimin e kontestuar e ka pranuar më 26 shkurt 2018.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se janë shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], nenin 46 [Mbrotjtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) si dhe me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) dhe me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për Mbrotjtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 4, të nenit 21 [Parimet e përgjithshme] dhe paragrafin 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).
6. Më 31 maj 2018, Gjykata miratoi, në seancë administrative, plotësim-ndryshimin e Rregullores së punës, e cila u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më 21 qershor 2018 dhe hyri në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht, gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata i referohet dispozitave juridike të rregullores së re në fuqi.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

7. Më 7 qershor 2018, parashtruesi i kërkesës e parashtroi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
8. Më 16 qershor 2018, u përfundoi mandati gjyqtarëve: Snezhana Botusharova dhe Almiro Rodrigues. Më 26 qershor 2018, u përfundoi mandati gjyqtarëve: Altay Suroy dhe Ivan Čukalović.
9. Më 9 gusht 2018, Presidenti i Republikës së Kosovës emëroi gjyqtarët e rinj: Bajram Ljatifi, Safet Hoxha, Radomir Laban, Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.
10. Më 23 gusht 2018, në pajtim me rregullin 40.1 të Rregullores së punës, Kryetarja e Gjykatës urdhëroi bashkimin e kërkesave KI36/18, KI60/18,

KI65/18, KI80/18, KI81/18, KI82/18, KI109/18, KI122/18, KI123/18 dhe KI124/18. Gjyqtar raportues në të gjitha rastet u caktua gjyqtari Bekim Sejdiu.

11. Më 11 shtator 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi Kolegjin shqyrtues, për të gjitha kërkesat e bashkuara, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Gresa Caka-Nimani dhe Radomir Laban.
12. Më 12 shtator 2018, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe Gjykatën Supreme për bashkimin e kërkesave KI36/18, KI60/18, KI65/18, KI80/18, KI81/18, KI82/18, KI109/18, KI122/18, KI123/18 dhe KI124/18.
13. Më 14 shtator 2018, Gjykata e njoftoi Gjykatën Themelore në Prishtinë për regjistrimin dhe bashkimin e rasteve dhe kërkoi nga ajo që të dorëzojë në Gjykatë fletëkthesat lidhur me lëndët: KI36/18, KI81/18, KI82/18 dhe KI124/18.
14. Më 1 tetor 2018, Gjykata Themelore në Prishtinë i dorëzoi në Gjykatë fletëkthesat e kërkuara.
15. Më 17 tetor 2018, parashtruesi i kërkesës dorëzoi një shkresë në Gjykatë, ku kërkoi që kërkesa me nr. KI109/18 të shqyrtohet ndaras nga kërkesa me nr. KI36/18, duke pretenduar se rastet nuk janë të së njëjtës natyrë.
16. Më 5 prill 2019, Gjykata shqyrtoi dhe e miratoi kërkesën e parashtruesit lidhur me ndarjen e kërkesës KI109/18 nga kërkesa me numër KI36/18. Po ashtu, Gjykata në përputhje me rregullin 40 (3) të Rregullores së punës vendosi që kërkesat KI36/18, KI60/18, KI65/18, KI80/18, KI81/18, KI82/18, KI109/18, KI122/18, KI123/18 dhe KI124/18 të shqyrtohen ndaras, me të njëjtin gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues.
17. Më 11 prill 2019, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe Gjykatën Supreme për ndarjen e kërkesave KI36/18, KI60/18, KI65/18, KI80/18, KI81/18, KI82/18, KI109/18, KI122/18, KI123/18 dhe KI124/18.
18. Më 12 prill 2019, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë një parashtresë të titulluar *“Parashtresë, lidhur me lëndët e regjistruara në Gjykatën Kushtetuese, dhe në veçanti për lëndën e regjistruar në Gjykatën Kushtetuese me numër 132/18”*, në të cilën ai në thelb i përsëriti pretendimet që i kishte bërë më parë.
19. Më 16 maj 2019, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë një parashtresë të titulluar *“Parashtresë, lidhur me lëndët e regjistruara në Gjykatën Kushtetuese”*, në të cilën ai në thelb i ripërsëriti pretendimet që i kishte bërë më parë.
20. Më 6 nëntor 2019, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve të rastit

21. Më 12 gusht 2010, Qeveria e Republikës së Kosovës dhe parashtruesi i kërkesës kishin nënshkruar një Marrëveshje të Partneritetit Publiko Privat (në tekstin e mëtejshëm: MPPP). Para marrëveshjes së MPPP-së, Aeroporti i Prishtinës është quajtur Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës “ Adem Jashari” (në tekstin e mëtejshëm: ANP). Bazuar në Marrëveshjen e MPPP-së, parashtruesi i kërkesës kishte marrë obligim që punëtorët t’i mbajë në punë edhe për 3 (tre) vite të tjera.
22. Në bazë të shkresave të lëndës vërehet se G.U. (në tekstin e mëtejshëm: punëtori) kishte qenë i punësuar tek ANP-ja nga data 20 tetor 2002 deri më 3 prill 2011.
23. Pas nënshkrimit të MPPP-së, punëtori ka qenë në marrëdhënie të rregullt pune te parashtruesi i kërkesës nga 4 prilli 2011 deri më 3 prill 2014. Më 3 mars 2014, përkatësisht 30 (tridhjetë) ditë para skadimit të kontratës, parashtruesi i kërkesës e kishte njoftuar punëmarrësin se nuk do t’i ofrohet kontratë e re e punës pas skadimit të kontratës ekzistuese me arsyetimin se kontrata nuk po i vazhdohet me *“[...] politikat e Bordit të Drejtorëve për planifikimin e ardhshëm të resurseve njerëzore”*.
24. Më 17 prill 2014, punëtori ka parashtruar ankesë tek parashtruesi i kërkesës (punëdhënësi) lidhur me njoftimin për mos ripërtëritjen e kontratës së punës, duke kërkuar që i njëjti të anulohet.
25. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës kishte refuzuar si të pabazuar ankesën e punëtorit.
26. Sipas shkresave të lëndës, vërehet se më 27 mars 2014, Trupi Ekzekutiv i Inspektoratit të Punës të Kosovës, përmes Vendimit Vn.45/2014, kishte urdhëruar parashtruesin e kërkesës *“që të zbatonte dispozitat e neneve 10.5 dhe 71 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212”*.
27. Në një datë të pasaktësuar, punëtori paraqiti kërkesëpadi në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Themelore), ku kërkoji që të anulohet Njoftimi i 3 marsit 2014, i lëshuar nga parashtruesi i kërkesës, dhe të obligohet parashtruesi i kërkesës që punëtorin ta kthejë në punë me të gjitha të drejtat dhe obligimet dhe shpërblim të dëmit.
28. Më 4 maj 2015, Gjykata Themelore, përmes Aktgjykimit C. nr.239/2014, ka aprovuar kërkesëpadinë e punëtorit si të bazuar dhe detyroi parashtruesin e kërkesës (gjegjësisht punëdhënësin) që: (i) ta kthejë në punë punëtorin (ii) t’ia paguajë shumën përkatëse punëtorit në emër të dëmit material dhe (iii) punëtorit t’ia paguajë shumën e të ardhurave për periudhën prej prej 25 prillit 2015 e deri tek pagesa definitive si dhe (iv) të mbulojë shpenzimet e procedurës kontestimore.
29. Gjykata Themelore kishte arsyetuar se punëtori në mënyrë të pandërprerë ka punuar për 10 (dhjetë) vjet te parashtruesi i kërkesës dhe paraardhësi i tij në Aeroportin Ndërkombëtar “Adem Jashari”. Më tutje, Gjykata Themelore konstatoi se *“në bazë të nenit 10.5 të Ligjit të Punës, Gjykata erdhi deri te*

përfundimi se marrëdhënia e punës në kohë të caktuar e paditëses tek e paditura konsiderohet marrëdhënie e punës në kohë të pacaktuar, andaj gjykata konsideron se me këtë situatë e paditura për me ja shkëputë kontratën e punës paditëses ka qenë e obliguar që të udhëheqë procedure te brendshme për ndërprerje të marrëdhënies së punës, procedurë kjo e cila nuk është udhëhequr tek e paditura, por paditësja vetëm është njoftuar me njoftimin për mospertritjen e kontratës së punës.”

30. Parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore C. nr. 239/2014, në Gjykatën e Apelit të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata e Apelit), duke pretenduar shkelje thelbësore të dispozitave procedurale, konstatim të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale.
31. Më 3 tetor 2017, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit (AC.nr.3626/2015) kishte refuzuar, si të pabazuar, ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe kishte vërtetuar Aktgjykimin të Gjykatës Themelore (C. nr. 239/2014) duke e konsideruar të njëjtin si të drejtë dhe të ligjshëm. Gjykata e Apelit arsyetoi se gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye konkrete për faktet vendimtare duke dhënë shpjegime adekuate për një vendosje të këtillë të bazuar në dispozitat përkatëse ligjore.
32. Në një datë të pasaktësuar, parashtruesi i kërkesës paraqiti revizion në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, duke pretenduar shkelje thelbësore të dispozitave procedurale dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.
33. Më 9 janar 2018, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit Rev. nr.2/2018, refuzoi si të pabazuar revizionin e parashtruesit të kërkesës, duke e vlerësuar vendimin e goditur si të drejtë, me arsyetimin se janë dhënë arsye të mjaftueshme për faktet relevante për gjykim të drejtë të kësaj çështje.
34. Në Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, ndër të tjera, theksohet se “[...] i padituri nuk ka paraqitur fakte të besueshme për të argumentuar pretendimet lidhur me shkeljet e pretenduara dhe për rrjedhojë ligjshmërinë e njoftimit për mos vazhdimin e kontratës së punës së paditësit Në këtë kontest relevant është fakti se paditësi në të njëjtin vend pune ka punuar për më tepër se 10 (dhjetë) vite dhe se kontrata e tillë e punës në kuptim të nenit 10 par 5. Të Ligjit të Punës konsiderohet si kontratë për një periudhë të pacaktuar kohore kështu që paditësit kanë pasur mundësi që t’i ndërprerët marrëdhënia e punës vetëm në kushtet e caktuara me dispozitën e nenit 70 të Ligjit të Punës, e jo në bazë të nenit 67 par 1 dhe 3 të këtij Ligji, ashtu si drejtë kanë vlerësuar dy gjykatat.”

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

35. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se me vendimin e kontestuar i janë shkelur të drejtat e tij, të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], nenin 46 [Mbrotja e Pronës] të Kushtetutës si dhe me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) dhe me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës.

36. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme nuk ka dhënë arsyetim të mjaftueshëm në vendimin e saj. Në lidhje me këtë pretendim, parashtruesi thekson se: *“aktgjykimi i Gjykatës Supreme nuk ka arsyetim të mjaftueshëm, sidomos në lidhje me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore (erores in procedanto) të Ligjit të Procedurës Kontestimore.”*
37. Parashtruesi i kërkesës pohon se Gjykata Supreme në aktgjykimin përkatës ka bërë zbatim të gabuar të së drejtës materiale *“erores in iudicando”* dhe ka interpretuar gabimisht nenin 10.5 të Ligjit të Punës, nr. 03/L-212 dhe MPPP-së sepse, sipas parashtruesit, punëmarrësi nuk kishte 10 (dhjetë) vjet pune të pandërprerë tek parashtruesi.
38. Lidhur me këtë, parashtruesi i kërkesës thekson se Gjykata Supreme do të duhej të kishte marrë parasysh nenin 9.18 të MPPP-së sipas së cilit parashtruesi i kërkesës merr për obligim t'i mbajë punëtorët në punë me afat prej tre (3) vjetësh.
39. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu citon Aktgjykimin KI138/15 e Gjykatës Kushtetuese dhe pohon se *“aplikimi i të drejtës materiale që mund të ishte fakt, ishte përcaktuese për marrjen e aktgjykimit të asaj gjykate porse Gjykata Supreme nuk e adresoj fare këtë çështje dhe vetëm konstatoi që gjykatat e shkallëve më të ulëta në mënyrë të drejtë kanë zbatuar dispozitat e ligjit material”*.
40. Andaj, parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme nuk e ka arsyetuar mjaftueshëm aktgjykimin e saj dhe nuk i ka trajtuar çështjet e ngritura me aktgjykimet e gjykatave të shkallëve më të ulëta.
41. Parashtruesi i kërkesës, kërkon që Gjykata ta shfuqizojë Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, dhe që çështja të kthehet në rigjykim.

Dispozitat përkatëse ligjore

Ligji Nr. 03/L-212 i Punës

Neni 10 [Kontrata e Punës]

- 1. Kontrata e punës lidhet në formë të shkruar dhe nënshkruhet nga punëdhënësi dhe i punësuar.*
- 2. Kontrata e Punës mund të lidhet për:*
 - 2.1. një periudhë të pacaktuar;*
 - 2.2. një periudhë të caktuar; dhe*
 - 2.3. për punë dhe detyra specifike.*
- 3. Kontrata e punës që nuk përmban kurrfarë hollësish për kohëzgjatjen e*

vet, duhet të konsiderohet si kontratë në periudhë të pacaktuar.

4. Kontrata për periudhë të caktuar nuk mund të lidhet për një periudhë më të gjatë se dhjetë (10) vite.

5. Kontrata për një periudhë të caktuar që ripërtërihet në mënyrë të qartë ose të vetëkuptueshme për një periudhë të punësimit më të gjatë se dhjetë (10) vite, konsiderohet si kontratë për një periudhë të pacaktuar kohore.

Neni 67

[Ndërprerja e Kontratës së Punës sipas fuqisë ligjore]

1. Kontrata e Punës sipas fuqisë ligjore, ndërpritet:

[...]

1.3. me skadimin e kohëzgjatjes së kontratës;

Neni 70

[Ndërprerja e Kontratës së Punës nga ana e punëdhënësit]

1. Punëdhënësi mund t'ia ndërpresë kontratën e punës të punësuarit me një periudhë paralajmërimi, atëherë kur:

1.1. ndërprerja e tillë arsyetohet për arsye ekonomike, teknike ose organizative;

1.2. i punësuari nuk është më i aftë t'i kryejë detyrat e punës;

1.3. punëdhënësi mund ta ndërpresë kontratën e punës në rrethanat e përcaktuara në nënparagrafin 1, 1 dhe 1, 2 të këtij paragrafi nëse është e papërshtatshme për punëdhënësin që ta transferojë të punësuarin në një vend pune tjetër, ta trajtojë a ta kualifikojë atë për ta kryer punën ose ndonjë punë tjetër;

1.4. punëdhënësi mund t'ia ndërpresë kontratën e punës të punësuarit në periudhën e kërkuar të paralajmërimit të ndërprerjes në:

1.4.1. rastet e rënda të sjelljes së keqe të punonjësit; dhe

1.4.2. për shkak të përmbushjes së pakënaqshme të detyrave të punës.

1.5. punëdhënësi duhet ta njoftojë të punësuarin për largimin e tij/saj menjëherë pas rastit që shpie në largim, ose sapo punëdhënësi të jetë vënë në dijeni të atij rasti;

1.6. punëdhënësi mund t'ia ndërpresë kontratën e punës të punësuarit pa periudhën e kërkuar të paralajmërimit të ndërprerjes, atëherë kur:

1.6.1. i punësuari është fajtor për përsëritjen e një keqsjelljeje më pak serioze ose të shkeljes së detyrimeve;

1.6.2. performanca e të punësuarit mbetet e pakënaqshme përkundër paralajmërimit me shkrim.

2. Punëdhënësi mund ta ndërpresë kontratën e punës në bazë të nën paragrafit 1.6. të paragrafit 1. të këtij neni vetëm atëherë kur i punësuari ka marrë përshkrimin në formë të shkruar të performancës së pakënaqshme, një afat të përcaktuar kohor brenda të cilit i punësuari duhet ta përmirësojë performancën e vet, si dhe një deklaratë se dështimi për përmirësimin e performancës do të rezultojë me largim nga puna pa asnjë paralajmërim të mëtejshëm me shkrim.

[...]

Neni 71

[Koha e njoftimit për ndërprerjen e kontratës së punës]

1. Punëdhënësi mund të ndërpresë kontratën e punës në kohë të pacaktuar në bazë të nenit 70, të këtij ligji në këto intervale kohore të njoftimit:

1.1. prej gjashtë (6) muaj deri në dy (2) vite punësim, tridhjetë (30) ditë kalendarike;

1.2. prej dy (2) deri në dhjetë (10) vite punësimi, dyzetepesë (45) ditë kalendarike;

1.3. mbi dhjetë (10) vite punësim, gjashtëdhjetë (60) ditë kalendarike.

2. Punëdhënësi mund të ndërpresë kontratën e punës për kohë të caktuar me njoftim prej tridhjetë (30) ditësh kalendarike. Punëdhënësi i cili nuk ka për qëllim të ripërtërijë kontratën me periudhë të caktuar duhet të informojë punësuarin së paku tridhjetë (30) ditë para skadimit të kontratës. Dështimi për ta njoftuar nga punëdhënësi, do t'i japë të drejtën të punësuarit për zgjatjen e tridhjetë (30) ditëve kalendarike shtesë me pagë të plotë.

Marrëveshja për Partneritet Publiko privat për Operimin dhe Zgjerimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës

9.18 [Përfundimi i Personelit]

“Partneri Privat mund të përfundoj punësimin ose ndonjë angazhim të çfarëdo punëtori të ANP (i) në çdo kohë për çështjet në lidhje me ligjet , rregullat, dhe rregulloret administrative dhe dekretet e aplikuar (ii) sipas marrëveshjes së përbashkët , dhe (iii) pa kufizime pas përvjetorit të tretë (3) të Datës së hyrjes në fuqi.”

Pranueshmëria e kërkesës

42. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.

43. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

44. Gjykata po ashtu i referohet paragrafit 4, të nenit 21 [Parimet e përgjithshme] të Kushtetutës, që përcakton:

“4. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme.”

45. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ka të drejtë të paraqes ankesë kushtetuese, duke u thirrur në shkelje të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të tij, që vlejnë për individët dhe personat juridikë (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese nr. KI41/09, parashtruesi i kërkesës *Universiteti AAB-RIINVEST L.L.C.*, Aktvendimi për papranueshmëri i 3 shkurtit 2010, par.14).
46. Në vazhdim, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohet në Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 47 [Kërkesa individuale] nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe nenit 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

- 1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.*
- 2. Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të këtë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.*

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. [...]”

47. Sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës (si person juridik) është palë e autorizuar e cila konteston aktet e një autoriteti publik, pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka sqaruar të drejtat dhe liritë që ai pretendon se i janë shkelur përmes këtyre vendimeve, në pajtim me kushtet që kërkohen nga neni 48 i Ligjit, dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.
48. Megjithatë, Gjykata duhet të vlerësojë më tej nëse janë plotësuar kriteret e parapara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës, duke përfshirë kushtin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Kështu, rregulli 39 (2) i Rregullores së punës, përcakton:

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”

49. Fillimisht, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon se i është shkelur e drejta e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, për shkak se vendimet e gjykatave të rregullta nuk janë arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme, ndërsa shkeljet e të drejtave të tjera të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ parashtruesi i paraqet si pasojë e shkeljes të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.
50. Thelbi i pretendimeve të parashtruesit të kërkesës është që Gjykata Supreme nuk e ka arsyetuar mjaftueshëm Aktgjykimin e saj dhe ka interpretuar gabimisht nenin 10.5 të Ligjit të Punës, nr. 03/L-212 sepse sipas parashtruesit, punëmarrësi nuk kishte 10 (dhjetë) vjet pune të pandërprerë tek parashtruesi. Më tutje, parashtruesi i kërkesës e kishte argumentuar këtë duke u mbështetur në nenin 9.18 të MPPP-së sipas së cilit ky i fundit merr për obligim t'i mbajë punëtorët në punë me afat prej 3 (tre) vjetësh. Parashtruesi i kërkesës po ashtu pretendon në shkelje të së drejtës së tij kushtetuese për mjete efektive juridike si pasojë e mungesës së arsyetimit të vendimit të kontestuar.
51. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta e kanë interpretuar gabimisht ligjin kur i janë referuar përvojës së punës së punëtorit, duke pretenduar se gjykata në rastin në fjalë do të duhej të konsideronte se bëhet fjalë për dy punëdhënës të ndryshëm (duke iu referuar kështu Aeroportit Ndërkombëtar “Adem Jashari”, para dhe pas nënshkrimit të MPPP) dhe duke theksuar se punëtori nuk i kishte më shumë se 10 (dhjetë) vjet pune tek parashtruesi i kërkesës”.
52. Përkitazi me këto pretendime të parashtruesit të kërkesës, Gjykata fillimisht vë në pah se Gjykata Supreme gjatë shqyrtimit të kërkesës për revizion të parashtruesit arsyetoi se *“paditësja në të njëjtin vend pune punon më tepër se 10 vite, dhe kontrata e saj e punës konsiderohet në kuptim të nenit 10.5 të Ligjit të Punës, si kontratë për një periudhë të pacaktuar kohor, kështu që të njëjtës ka pasur mundësi t'i ndërpritet marrëdhënia e punës vetëm nën kushtet e parapara në nenin 70 të Ligjit të cekur, e kurrsesi në bazë të nenit 67.1 dhe 3 të këtij ligji, ku thuhet se kontrata e punës sipas fuqisë ligjore, ndërpritet me skadimin e kohëzgjatjes së punës”*.
53. Lidhur me pretendimet konkrete të parashtruesit të kërkesës për zbatueshmërinë e nenit 9. 18 të MPPP-së, Gjykata Supreme arsyetoi se *“pretendimet ne revizion se miratimi i kërkesëpadisë së paditësit është në kundërshtim me nenin 9.18 të Marrëveshjes për Partneritetin Publik privat të lidhur mes të paditurit dhe Republikës së Kosovës, ka qene objekt i shqyrtimit dhe vlerësimit të gjykatës se shkallës së dyte ku drejt është vlerësuar se me këtë dispozitë nuk parashihet edhe ndërprerja e kontratave të punësimit të punëtorëve në kundërshtim me ligjet pasi që me këte marrëveshje, parashihet që partneri privat, këtu i padituri, mund të pranojë punësimin ose ndonjë angazhim të cfarëdo. punëtori ta ANP-së, në ,do kohë për çështje në lidhje me ligjin, rregullat dhe Rregulloret administrative dhe dekretet e aplikuara sipas*

marrëveshjes se par pa kufizime, pas përvjetorit të tretë te hyrjes ne fuqi te kësaj marrëveshje.”

54. Në dritën e këtyre argumenteve të Gjykatës Supreme, Gjykata konstaton se të gjitha argumentet e parashtruesit të kërkesës, të cilat ishin të rëndësishme për zgjidhjen e kontestit të tij, janë parashtruar dhe shqyrtuar siç duhet nga gjykatat e rregullta. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se procedurat në gjykatat e rregullta, të shikuara në tërësinë e tyre, ishin të drejta (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese KI128/18, parashtrues i kërkesës, *Limak Kosovo International Airport J. S. C. “Adem Jashari”*, Aktvendim për papranueshmëri i 27 majit 2019, KI129/18, parashtrues i kërkesës, *Limak Kosovo International Airport J. S. C. “Adem Jashari”*, Aktvendim për papranueshmëri i 20 qershorit 2019, KI130/18, parashtrues i kërkesës, *Limak Kosovo International Airport J. S. C. “Adem Jashari”*, Aktvendim për papranueshmëri i 20 qershorit 2019).
55. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës thirret në Aktgjykimin KI138/15 të Gjykatës Kushtetuese, duke pohuar se *“aplikimi i të drejtës materiale që mund të ishte fakt, ishte përcaktuese për marrjen e Aktgjykimit të asaj gjykate por se Gjykata Supreme nuk e adresoj fare këtë çështje dhe vetëm konstatoi që gjykatat e shkallëve më të ulëta në mënyrë të drejtë kanë zbatuar dispozitat e ligjit material.”*
56. Sa i përket këtij pretendimi të parashtruesit të kërkesës, Gjykata rikujton se rasti i përmendur dallon nga rasti i cili gjendet para nesh, për shkak të këtij arsytimi: (i) çështja e procedurës disiplinore kundër të punësuarit tek parashtruesi i kërkesës në atë rast është shqyrtuar në mënyrë të ndryshme nga gjykatat e rregullta; (ii) nuk ka qenë e qartë baza juridike, sipas së cilës është zhvilluar procedura disiplinore; (iii) kanë ekzistuar elementet kontradiktore në vendimet e gjykatave të shkallës më të ulët. Përveç kësaj, Gjykata e Apelit e aplikoi dhe shfrytëzoi për arsytim Udhëzimin Administrativ i cili rezultoi nga Rregullorja për Shërbimin Civil, e jo nga Ligji i Punës. Ky argument, edhe pse është ngritur nga parashtruesi i kërkesës në këtë rast, nuk është shqyrtuar nga Gjykata Supreme (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese KI138/15, *Sharr Beteiligung GmbH*, Aktgjykim i 4 shtatorit 2017).
57. Në dritën e trajtimeve të mësipërme, Gjykata vë theksin në qëndrimin e saj të përgjithshëm se, parimisht, nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta gjatë vlerësimit të provave apo zbatimit të ligjit (ligjshmëria), përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura nga Kushtetuta (kushtetutshmëria). Është roli i gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 21 janarit 1999, *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, Nr. 30544/96, para. 28).
58. Vërtetimi i plotë i gjendjes faktike dhe aplikimi i drejtë i ligjit është detyrë parësore dhe brenda juridiksionit të gjykatave të rregullta (çështje e ligjshmërisë). Prandaj, Gjykata Kushtetuese nuk mund të veprojë si “gjykatë e shkallës së katërt” (shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimin e GJEDNJ-së i 16 shtatorit 1996, *Akdivar kundër Turqisë*, nr. 21893/93, para. 65, shih, po ashtu,

mutatis mutandis, rastin e Gjykatës Kushtetuese KI86/11, parashtrues i kërkesës *Milaim Berisha*, Aktvendim për papranueshmëri i 5 prillit 2012).

59. Si rrjedhojë, Gjykata konstaton se e drejta në gjykim të drejtë dhe të paanshëm e parashtruesit të kërkesës nuk i është shkelur nga vendimet e autoriteteve publike.
60. Gjykata rikujton se fakti i thjeshtë se parashtruesit e kërkesave nuk pajtohen me rezultatin e vendimeve të Gjykatës Supreme (dhe gjykatave të shkallës më të ulët) nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim të argumentuar për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesave duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih, *mutatis mutandis*, rastin e Gjykatës Kushtetuese KI136/14, *Abdullah Bajqinca*, Aktvendim për papranueshmëri, i 10 shkurtit 2015, paragrafi 33).
61. Si përmbledhje, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur dëshmi, fakte dhe argumente që dëshmojnë se procedurat në gjykatat e rregullta kanë shkaktuar shkelje të të drejtave të tij të garantuara me Kushtetutë, gjegjësisht me nenet 24, 31, 32 dhe 46 të Kushtetutës, në ndërlidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
62. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe deklarohet e papranueshme në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullat 39 (2) dhe 59 (b) të Rregullores së punës, më 6 nëntor 2019, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Bekim Sejdiu



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi